

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Eric Wendt nis sot misionin si ambasador i SHBA-së në Shqipëri, do t'i dorëzojë letrat kredenciale Begajt - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/eric-wendt-nis-sot-misionin-si-ambasador-i-shbase-ne-shqiper-i-do-ti-dorezoje-letrat-kredenciale-begajt?r=kh1
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 05:51:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 05:49:58 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a889a6d69026c9d4a2da876a0c42efaf35bf41fb42946bca821288f5bd4de6fe
TEKSTI	e559b45eea3e9546653641f837cfa29503bcc4e7be6a4fd827ba2e26e2cb818c
PAMJA	c1d011ef06be22d6054f2a2a79f309ee48545274e38fa280ccb47f4f80239391

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ba0ff75fff77cc09437b5840b8dcc6c85e3bb4da088b99b37e3bfa3b1dda015b
E MËPARSHMJA	f3f3e607b20d82bda3ee5524554cc133aac3b94620cf6d7cef8ef0d38bc5a0dc
RRËNJA MERKLE	a38a4fa799b1e73bbabeaa0ef113694411dbd892b18eb619eb2f3db166512539
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ba0ff75fff77cc09437b5840b8dcc6c85e3bb4da088b99b37e3bfa3b1dda015b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Sot ndeshja Shqipëri-Bjellorusi, policia plan masash! Nga ora 17:00 bllokohen rrugët rreth stadiumit 'Air Albania'



Politikë

Eric Wendt nis sot misionin si ambasador i SHBA-së në Shqipëri, do t'i dorëzojë letrat kredenciale Begajt

Eric Wendt nis sot misionin si ambasador i SHBA-së në Shqipëri, duke i dorëzuar në 11:00 letrat kredenciale Presidentit Bajram Begaj. Lufta kundër korrupsionit e krimit të organizuar, mbështetja për SPAK, siguria dhe investimet amerikane janë ndër prioritetet që ai ka renditur për mandatin e tij.



Eric Wendt dhe Bajram Begaj



Redaksia

26 Shtator, 07:39 | Përditësimi: 26 Shtator, 07:52

f Share Tweet



A A

Pas gati 3 vitesh, Ambasada Amerikane në Tiranë do të ketë sërish një ambasador. **Eric Wendt** nis këtë të shtunë misionin e tij në Shqipëri, duke pasuar Yuri Kim, e cila u largua në qershor të vitit 2023. Wendt do të pritët në orën 11:00 nga Presidenti **Bajram Begaj**, të cilit do t'i dorëzojë letrat kredenciale. Më pas, do të zhvillojnë një takim kokë më kokë.

Prej largimit të Yuri Kim, në krye të misionit diplomatik amerikan në Tiranë ka qenë Nancy VanHorn, si e ngarkuar me punë. I propozuar nga Presidenti Donald Trump dhe i **konfirmuar nga Senati amerikan më 6 gusht**, Wendt vjen në Tiranë me një profil kryesisht ushtarak dhe të sigurisë. Ai ka mbi 34 vite shërbim në ushtrinë amerikane, pjesën më të madhe në Forcat Speciale "Green Berets", ndërsa ka drejtuar edhe Komandën e Operacioneve Speciale të NATO-s.

Prioritetet e mandatit të tij në Shqipëri, Wendt i bëri të qarta që në dëgjuesën e 20 majit në Senat. Mes tyre renditi luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe trafikut të drogës, forcimin e bashkëpunimit në mbrojtje dhe sigurinë kibernetike.



LEXO EDHE:

Trump refuzon propozimin e Iranit për armëpushim, pritët të rifillojë bombardimet pas zgjedhjeve të nëntorit

Wendt shprehu mbështetje për SPAK, duke vlerësuar edhe bashkëpunimin e Strukturës së Posaçme me agjencitë amerikane të zbatimit të ligjit. Sipas tij, puna e SPAK mbetet kyçe për sa kohë institucioni ruan pavarësinë dhe qëndron larg ndikimeve politike.

Me 2 tetor, ambasadori i ri do të zhvillojë edhe pritjen zyrtare, ku të ftuar do të jenë përfaqësues të politikës shqiptare nga të gjitha krahët.

SLE./Shqiptarja.com

TAG: [Bajram Begaj](#) [Eric Wendt](#) [ambasada e shba](#) [SHBA](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komente

© Ndalohej repretisist ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH
COM

Sondazhi i ditës:

22 Shtator, 16:08

Arrestimet e fundit nga SPAK, a janë provë e pavarësisë nga politika?

Po Jo Disi

Lajme të tjera



SHBA/ Gjykata Supreme i lejon Trumpit të përdorë bazën e të dhënave 'kontroverse' për të kontrolluar shtetësinë e votuesve

25 Shtator, 22:52



Balla nga SHBA: Me Edi Ramën Shqipëria është ngjitur në majën më të lartë të historisë së shtetit shqiptar

25 Shtator, 20:42



Kryeministri Rama në OKB: Liria e shprehjes po kërcënohet nga përdorimi si armë i 'fuqisë së shpërndarjes'! Kur një gënjeshtër shumëfishohet, e vërteta varroset

25 Shtator, 19:47



Ylli Pata: Stina politike e Tiranës që inauguron ambasadori i ri i SHBA



Ylli Pata

25 Shtator, 18:32



U sulmua me vezë nga protestues në New York, reagon Rama: Flamurin kombëtar e kam ngritur më lart se kurrë, asgjë s'më ndal për ta çuar në majën e BE (VIDEO)

25 Shtator, 16:43



'Jo vetëm projekti i famshëm i Kushner'- Rama nga New York: Po përgatitemi të sjellim miliarda euro investime në Shqipëri

25 Shtator, 16:26



"Dikur korrupsioni ishte kudo, sot luftohet çdo ditë", Rama në New York: Sistemi demokratik i Shqipërisë po ndërton imunitetin e vet

25 Shtator, 16:10



Rama nga New York: Biden dhe SHBA e tradhtuan Thaçin, mund të bënin më shumë! Pas Zvërnecit, përgatitemi për investime të reja

25 Shtator, 16:07



Ambasadori i ri amerikan vjen në Shqipëri, të shtunën Eric Wendt dorëzon letrat kredenciale tek Presidenti Begaj



Danjela Maloku

25 Shtator, 14:50





Arresti i ish-kreut të SHISH, të hënën mblidhet Këshilli i Sigurisë Kombëtare! PD: Socialistët mbrojnë Hysenin! PS: Përgjegjësia personale

25 Shtator, 14:39



Von der Leyen nis turneun në Ballkan, të mërkurën vjen në Shqipëri! Anashkalon Serbinë dhe Bosnje-Hercegovinën

25 Shtator, 14:31



Begaj mbledh të hënën Këshillin e Sigurisë Kombëtare, Bardhi: Spektakël institucional! Të japë llogari për emërimin e Vlora Hysenit në krye të SHISH

25 Shtator, 13:19

[Kodi Etik](#)

[Kontakt](#)

[Rreth Nesh](#)

[Raportoni Ju](#)

[Puno me ne](#)

[Shqiptarja.com]

Kërko



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.